Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_

**Shtojca 8/1**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE  
LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

**Data e dorëzimit të deklaratës** \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

## Shtojca 9

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);*
- b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1;*
- c. Sigurimin e ofertës, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 4;*
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;*
- d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 8/1;*
- e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

Objekti i veprimtarisë së Operatoreve Pjesëmarrës duhet të perputhet me objektin e prokurimit.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

- a. Kopje të certifikuara të bilanceve të paraqitura në autoritetet përkatëse (Administrata Tatimore) të tre viteve të fundit, konkretisht të viteve 2017, 2018, 2019.
- b. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore për tre vitet e fundit, ku xhiroja mesatare e tre viteve, konkretisht 2017, 2018, 2019 të mos jete më të ulët se 62,880,000 (Gjashtedhjetë e dy milion e teteqind e tetëdhjetë mijë) leke pa tvsh.
- c. Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, ku vlera duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 62,880,000 (Gjashtedhjetë e dy milion e teteqind e tetëdhjetë mijë) leke pa tvsh.

Ne rast se kontrata është kryer me ente publike:

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Ne rast se kontrata është kryer me sektorin privat:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

### 2.3.2 Operatori i shërbimit duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme:

- a) **ISO 9001** për sistemin e menaxhimit të cilësisë (të vlefshme), ose ekuivalente, të përditësuar, e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen;
- b) Certifikatën për menaxhimin e shërbimeve **ISO 20000-1:2011** ose ekuivalente të përditësuar, e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen,
- c) Certifikatën për menaxhimin e informacionit **ISO 27001** ose ekuivalente të përditësuar, e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë në kategorinë dhe specifikën e produkteve apo shërbimeve që prokurohen.

**Çertifikatat të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.**

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të VKM-914 datë 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas aktmarrëveshjes.*

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për të gjithë mallrat objekt prokurimi.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.



**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit për të gjithë mallrat objekt prokurimi. Pjesa që i përket të dhënave teknike të jetë e përkthyer në gjuhën shqipe.

**2.3.5** Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues në ditën e hapjes së ofertave duhet të paraqesë nga një mostër për të dy produktet (lexues dhe tableta) të kërkuara në shtojcën 1, Formulari i ofertës.

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë që mallrat e furnizuara janë të reja (jo të rikonstruara).

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

## **Shtojca 10**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

#### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, parametrat teknik etj: \_\_\_\_\_

Specifikimi i Materialeve: \_\_\_\_\_

**Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

## 1. OBJEKTIVAT, QELLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

### 1.1. Objektivi i Përgjithshëm

Blerja PDA dhe Tablet si dhe monitorimi i punonjesve

### 1.2. Qëllimi

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përmes kësaj procedure prokurimi, OSHEE sh.a. ka për qëllim blerjen e 1000 pajisjeve të tipit PDA handheld që do të përdoren nga lexuesit e terrenit për të kryer leximin e matësve elektrikë dhe 600 tabletave që do të përdoren nga stafi i terrenit të OSSH-së për kryerjen e veprimeve operacionale në terren dhe reflektimin e tyre në sistemin e faturimit, si dhe Shërbimit që do të realizojë menaxhimin e këtyre pajisjeve si dhe monitorimin e përdoruesve.

Aktualisht OSHEE ka në përdorim dy aplikacione nje per leximin e matesave dhe nje tjetër per manaxhimin e tyre te cilat jane aplikacione per sisteme Android.

Duke qenë se pajisjet do të përdoren në kushte të vështira atmosferike, ofertuesi duhet të marrë parasysh të gjitha parametrat e duhur teknikë, të garantojë funksionimin e plotë të tyre si dhe garancinë e produktit për 2 vite.

Ofertuesi duhet të ofrojë trajnim për punonjësit e OSSH-së për përdorimin e duhur të këtyre pajisjeve.

### **Karakteristikat teknike të PDA (Kontrollerit) për mbledhjen e të dhënave të energjisë në pikën e lidhjes.**

PDA duhet të jetë një pajisje robuste e tipit industrial. Parametrat minimalë të pajisjes duhet të jenë si më poshtë:

- Sistemi Operativ Android 7 ose më lart;
- CPU të paktën 4 Core ;
- Frekuenca e CPU të paktën 1400 MHZ;
- Memorie RAM të paktën 2GB;
- Memorie ROM të paktën 16GB;
- GSM 900Mhz/1800MHZ (GPRS, EDGE), 3G (2100Mhz), 4G(2600Mhz).
- Ekran: multitouch me ngjyra mbi 4", të suportojë përdorimin me doreza (glove mode);
- Konstrukt: Industrial i standardit IP65 i markuar me logon e OSSH;
- GPS: Te suportojë AGPS, GPS dhe/ose sisteme të tjera Galileo/Glonass/Beidou etj.
- Bluetooth: 2.1/3.0/4.2, të suportojë BLE;
- WiFi: 2.4G/5G IEEE 802.11 a/b/g/n;
- Lexues barkodi: smart scan 2D
- Tastiera: 20 butona;
- 1 ndërfaqe USB-C;

- Të suportojë OTG (On-The-go);
- Kamera e pasme: mbi 13 Mpix flash, autofocus me funksione për video dhe foto në kushte atmosferike të vështira;
- Kamera ballore: mbi 2 Mpix fixfocus;
- Slot për SIM Card;
- Slot për SD Card;
- eSIM;
- NFC ISO 14443 Type A/B, FeliCa dhe ISO 15693 cards
- USB-C ushqyesin e energjisë;
- Bateri: 5000mAh ose me lart të ndryshueshem Removable
- Autonomia operative e baterisë: me shumë se 15 orë pune;
- Autonomia në gjendje stand by e baterisë në momentin e ndërrimit të Baterise
- Karikues: 5V, 2A.
- Pesha: <500 gram

Klasa e Mbrojtjes: IP65

Niveli i rezistencës në rënie nga lartësia: 1.5m

Temperatura e operimit: nga -20° C deri në 55°C;

Temperatura e mbajtjes në mjedis: nga -40° C deri në 70°C;

Pajisja duhet të ofrohet me çantë të personalizuar me logon e OSSH-së e cila të jete e varur në brez për lehtësi pune.

Pajisja duhet të ofrohet me rrip/varëse të personalizuar me logon e OSSH-së.

Pajisja PDA(kontrolleri) duhet të jetë me ngjyra të lehtësisht të dallueshme nga syri i njeriut, si dhe duhet të jete i markuar me logon e OSSH-së

### **Karakteristikat teknike të tabletit për përdorim në terren.**

Tableta duhet të jetë një pajisje robuste përdorim industrial. Parametrat minimalë teknikë të pajisjes duhet të jenë si më poshtë:

- Sistemi Operativ Android 9.0 ose më lart;
- CPU të paktën 8 Core 2200 MHz;
- Frekuenca e CPU të paktën 2200 MHz;
- Memorie RAM të paktën 4GB;
- Memorie ROM të paktën 64GB;
- GSM 900Mhz/1800MHZ (GPRS, EDGE), 3G(2100Mhz), 4G(2600Mhz);
- Ekran: multitouch Full HD mbi 10.1", të suportojë përdorimin me doreza (glove mode) dhe me duar të lagura;
- Konstrukti: Industrial i standardit IP65 i markuar me logon e OSSH.
- GPS: Te suportojë AGPS, GPS
- Bluetooth: 2.1/3.0/4.1/4.2/5.0, të suportojë BLE;
- WiFi: 2.4G/5G IEEE 802.11 a/b/g/n/ac;
- Të ketë sensorët e: gravitetit, busullës, dritës, fushës magnetike.
- 1 ndërfaqe USB-C;
- 1 ndërfaqe jack për audio;

- Kamera e pasme: mbi 13 Mpix flash, autofocus me funksione për video dhe foto në kushte atmosferike të vështira, të suportojë njohjen e barcode 1D/2D.
- Kamera ballore: mbi 5 Mpix fixfocus;
- Slot për SIM Card;
- eSIM;
- NFC ISO 14443 Type A/B, FeliCa dhe ISO 15693 cards
- USB-C ushqyesin e energjisë;
- 2 mikrofonë;
- Bateri mbi 8200mAh.
- Autonomia operative e baterisë: me shumë se 12 orë pune;
- Autonomia në gjendje stand by e baterisë: më shumë se 20 ditë;
- Karikues: 5V,
- Pesha: <700 gram

Klasa e Mbrojtjes: IP65

Niveli i rezistencës në rënie nga lartësia: 1 m

Temperatura e operimit: nga -20° C deri në 55°C;

Temperatura e mbajtjes në mjedis: nga -40° C deri në 70°C;

### **Specifikimet e Sistemit të monitorimit të përdoruesve**

Software i pajisjeve handheld si dhe tabletave duhet të suportohet nga Android 7+ dhe duhet të jetë i azhurnuar deri në sistemet e fundit operativ android.

Sistemi do të ketë dy pjesë përbërëse: shërbim i fshehtë (backgroundservice) të instaluar në pajisje si dhe sistemi web-based që do të realizojë monitorimin.

Specifikimet teknike për platformën software jepen në vijim:

Objektivi i sistemit të portuar në platformën Android është monitorimi i stafit në terren nga Zyrat Qendrore të OSSH-së. Ky shërbim duhet të jetë i instaluar në të gjitha pajisjet PDA dhe Tableta.

#### **1. Karakteristika të përgjithshme**

Sistemi duhet të jetë i aksesueshëm nga shfletuesit e ndryshëm si Internet Explorer, Mozilla Firefox, Google Chrome etj. Një sistem i tillë do të shkurtojë kohën që i duhet stafit të drejtorisë së IT dhe OSSH-së për të instaluar dhe konfiguruar një aplikacion tradicional desktop.

Sistemi duhet të zhvillohet si pjesë e sistemit aktual, duke u integruar plotësisht në nivelin e të dhënave (database), në nivelin logjik (server side), në ndërfaqen e programit (client side). Integrimi i plotë i përmendur më sipër duhet të jetë si në ndërfaqen web të administrimit ashtu edhe në atë të pajisjeve (kontrollerave) që përdor personeli i OSHEE-së.

Parametrat dhe komandat software për operimin dhe komandimin e pajisjeve të pikave të lidhjes, do t'i vihen në dispozicion ofertuesit pas nënshkrimit të kontratës. Pajisjet do të operojnë duke përdorur GPRS/3G/4G për komunikim me sistemin qendror.

### 1.1 Siguria e aksesimit

Sistemi duhet të ofrojë siguri në akses duke implementuar politika të konfigurueshme për rregullat mbi kredencialet e autentifikimit. Si minimum duhet të ofrojë:

- skadencën e konfigurueshme të kredencialeve;
- vendosjen e detyrimeve për ndryshimin periodik të kredencialeve nga përdoruesit;
- vendosjen e detyrimeve ndaj përdoruesve për rritjen e fortësisë së kredencialeve duke përdorur karaktere special.

Sistemi duhet të ekspozojë në mënyrë të detajuar të gjitha funksionalitetet e tij në trajtën e të drejtave të përdorimit. Administratorët e sistemit duhet të mund të krijojnë role të specifikuar mirë në çdo detaj..

Sistemi i portuar dhe funksionalitetet e tij do të sillen si çdo funksionalitet i sistemit aktual duke adoptuar çdo veti të sigurisë.

### 1.2 Ruajtja e historikut të ndryshimeve

Sistemi duhet të ruajë historik të detajuar për ndryshimet që bëhen mbi entitetet. Në çdo moment administratorët e sistemit duhet të mund të shikojnë të dhëna mbi vlerën e vjetër, vlerën e re, përdoruesin dhe orën e saktë kur është kryer modifikimi.

### 1.3 Procedurat e Back Up

Sistemi duhet të garantojë procedura të qarta për Back Up periodik të dhënave. Te dhënat duhet të kopjohen në server të ndryshëm fizikisht nga server ku është instaluar sistemi.

Backup duhet të integrohet dhe unifikohet me procedurat ekzistuese të back up të sistemit aktual.

### 1.4 Qëndrueshmëria e Sistemit

Sistemi duhet të ofrojë qëndrueshmëri të lartë duke përdorur arkitektura të shpërndarjes së ngarkesës së përpunimit (load-balancing) për të minimizuar kohën e mungesës së shërbimit (downtime).

Sistemit duhet të integrohet dhe të unifikohet nga qëndrueshmëria me sistemin aktual.

### 1.5 Zgjerueshmëria e Sistemit

Sistemi duhet të ngrihet mbi një arkitekturë të mirëmenduar për të lehtësuar shkallëzimin e biznesit në rastin e rritjes të numrit të transaksioneve dhe volumit të të dhënave që ngarkohen në sistem.

### 1.6 Optimizimi i përdorimit të bandës

Sistemi duhet të përdorë teknika për optimizimin e përdorimit të bandës në të gjitha nivelet si p.sh: Cache e cila minimizon aksesimin e databazës, por gjithashtu minimizon bandën e përdorur.

### 1.7 Mbrojtja e sistemit nga sulmet kibernetike

Sistemi duhet të inkorporojë komponentë IDS (intrusion detection system), e cila realizon mbrojtjen nga sulmet kibernetike duke vendosur rregulla në nivel firewall-i duke identifikuar kërkesat e dyshimta në bazë të modeleve të konfiguruar.

### 1.8 Politika për shfrytëzimin e kodit burimor, arkitektura e sistemit

Sistemi duhet të jetë me kod të hapur, në mënyrë që stafi i departamentit IT të mund të zgjerojë apo modifikojë funksionalitetet e sistemit, nëse do të jetë e nevojshme në të ardhmen. Arkitektura

e sistemi duhet të jetë e shtresëzuar dhe kodi duhet të jete i organizuar në klasa të ripërdorshme për të thjeshtuar zgjerimet/modifikimet e ardhshme. Sistemi duhet të jetë i gatshëm për integrim me sisteme të palëve të treta me anë të web shërbimeve. Web shërbimet duhet të garantojnë aksesimin e sigurt, duke përdorur kredenciale autentifikimi dhe OTP (one time password).

#### 1.9 Versionimi dhe aplikimi i modifikimeve

Kodi burimor i sistemit duhet të ruhet në një sistem versionimi GIT/SVN/CVS etj. Aplikimi i shtimit apo modifikimeve të funksionaliteteve duhet të bëhet sipas procedurave operative të mirëpërcaktuara, të cilat duhet të përfshijnë plane për rikthimin në gjendjen e mëparshme të sistemit në rast dështimi.

#### 1.10 Manuali i përdorimit dhe dokumentacioni teknik

Sistemi duhet të shoqërohet me manual përdorimi në gjuhën shqipe dhe të shpjegojë në mënyrë të qarte dhe të kuptueshme të gjitha funksionalitetet e ofruara. Sistemi duhet të shoqërohet me dokumentacion teknik në gjuhën shqipe. Në rast të shtimit apo modifikimit të funksionaliteteve dokumentacioni përkatës duhet të përditësohet.

### **Karakteristika të veçanta funksionale**

Më poshtë vijon specifikimi i karakteristikave të veçanta që duhet të plotësojë sistemi i portuar në mënyrë të tillë që të realizojë funksionet aktuale, por gjithashtu të sjellë përmirësime të ndjeshme. Funksionalitetet paraqiten të ndara sipas pjesëve përbërëse të sistemit.

#### 2.1 Karakteristika funksionale të pjesës së administrimit

Ndërfaqja e administrimit është panel i kontrollit për të gjithë sistemin. Në këtë ndërfaqe përdoruesit menaxhojnë të gjitha të dhënat, të cilat akumulohen nga puna në terren, marrin raporte operacionale dhe gjithashtu raporte të ndryshme për performancën e personelit dhe raporte të tjera të nevojshme për mirëorganizimin e punës. Ndërfaqja e administrimit duhet të jetë e thjeshtë dhe intuitive për të përdorur në mënyrë të tillë që të minimizojë kohën e nevojshme për përshtatjen e përdoruesve me të.

2.1.1 Sistemi duhet të mundësojë menaxhimin e shpërndarjes të pajisjeve, duke lejuar stafin qendror të OSSH-së të monitorojë shpërndarjen e pajisjeve.

2.1.2 Sistemi duhet të mundësojë monitorimin e proceseve që janë në ekzekutim në pajisje.

2.1.3 Sistemi duhet të japë mundësinë e shfaqjes së pozicionit gjeografik në hartë të pajisjes, si dhe të gjenerohet lëvizja e personelit në formë raportesh.

2.1.4 Sistemi duhet të monitorojë në kohë reale nivelin e baterisë të pajisjes për secilin nga punonjësit.

#### 2.2 Karakteristika funksionale të Shërbimit për përdoruesit në terren

Ky aplikacion duhet të funksionojë në pajisje portative (kontrollerave), të cilat operojnë me sistemin e operimit Android. Shërbimi duhet të jetë i testuar mirë, pasi do të përdoret për një kohë të gjatë dhe i shpërndarë në zona gjeografike të ndryshme. Pjesa e ndërveprimit midis Shërbimit dhe ndërfaqes së administrimit duhet të mendohet e pavarur e bazuar në teknologjitë e web shërbimeve.

2.2.1 Shërbimi duhet të funksionojë në background dhe nuk duhet të jetë e mundur mbyllja e Shërbimit nga përdoruesi fundor.

2.2.2 Shërbimi duhet të dërgojë të dhëna për vendndodhje gjeografike.

2.2.3 Njëpërmjet Shërbimit mund të merren të dhënat e ruajtura në PDA ose Tablets si docs, foto etj.

2.2.3 Shërbimi mbështetës për marrjen e pozicionit gjeografik duhet të parashikojë situatat kur përdoruesit gjenden në zona pa mbulim nga satelitet si p.sh.: brendësia e godinave etj. Në këtë rast Shërbimi mbështetës duhet të raportojë vendndodhjen e fundit të saktë që ka përcaktuar nga sinjali GPS.

2.2.4 Shërbimi duhet të komunikojë me Shërbimin mbështetës të marrjes së pozicionit gjeografik, njëpërmjet teknikës inter-process communication. Në këtë mënyrë komunikimi është i sigurtë dhe i shpejtë.

2.2.5 Shërbimi duhet të sinkronizohet në kohë reale.

2.2.6 Shërbimi duhet të përdorë teknikat e kompresimit të informacionit për dërgimin e të dhënave në serverin qendror, duke përdorur sa më pak bandën e internetit.

2.2.7 Shërbimi duhet të përdorë teknika të verifikimit të dërgimit të saktë të të dhënave në server. Shërbimi gjithashtu duhet të përdorë teknika të menaxhimit të dështimit të lidhjes me server apo të ndërprerjes së dërgimit të të dhënave.

2.2.8 Shërbimi duhet të përdorë teknika për kriptimin e të dhënave që dërgon në server, duke parandaluar kështu interceptimin e tyre nga persona keqdashës.

### 2.3 Ndërveprimi midis pjesëve përbërëse

Ndërfaqja e administrimit duhet të ofrojë mundësi për inventarizimi e pajisjeve (kontrollerit) të përdoruesve, duke lejuar regjistrimin e informacioneve shtesë për çdo pajisje si p.sh.: status i pajisjes, personi i cili e ka në dorëzim pajisjen, versioni i Shërbimit të instaluar etj.

Ndërfaqja e administrimit duhet të mundësojë shfaqjen e fotografive të ngarkuara në sistem nga Shërbimi.

Ndërfaqja e administrimit duhet të ofrojë raporte në lidhje me lëvizjen e përdoruesit, statusin e baterisë, fotot e bëra etj.

Ndërfaqja e administrimit duhet të mundësojë shfaqjen në hartë të itinerarit të një përdoruesi në një segment kohor të caktuar

Ndërfaqja duhet të ofrojë panele me informacion të shpejtë në trajtën e grafikëve të llojeve të ndryshme për përdoruesit qendrorë.

Informacioni për gjenerimin e grafikëve duhet të ekspozohet në trajtën e web shërbimeve REST në mënyrë të tillë që në të ardhmen këto të dhëna të përdoren për gjenerimin e grafikëve në aplikacione të tjera për smartphone, duke u dhënë menaxherëve të niveleve të larta informacion të shpejtë.

Ofertuesi duhet të ofrojë support për riparimin e pajisjeve gjatë periudhës së kontratës edhe për dëmtime që dalin jashtë garancisë. Suporti do të përfshijë këto pjesë:

- qarkun elektrik të pajisjeve;
- ekranin;
- strukturën apo konstruktin e pajisjes;
- sistemin e operimit;
- programin e instaluar në pajisje;

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Cmimi/Njesi	Vlera
-----	----------	--------	-------	-------------	-------



Dokumentat Standarde të Tenderit

---

1	Lexues PDA	cope	1000		
2	Tableta	cope	600		
3	Bateri per PDA	cope	100		
4	Software i sinkronizimit	set	1		
5	Trajnim I stafit	set	1		

**Afati i lëvrim: 45 Dite**

**Garancia e pajisjeve: 2 Vite**

**Shtojca11**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>	_____	_____
<b>02</b>	_____	_____
<b>03</b>	_____	_____
<b>...</b>	_____	_____

**Shtojca 12**

*( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT**

<b>Nr.</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Cmimi/Njesi</b>	<b>Vlera</b>
1	Lexues PDA	cope	1000		
2	Tableta	cope	600		
3	Bateri per PDA	cope	100		
4	Software i sinkronizimit	set	1		
5	Trajnim I stafit	set	1		

**Afati i lëvrimit: 45 Dite**

**Garancia e pajisjeve: 2 Vite**

**Shtojca 13**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

**NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>4</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

---

<sup>4</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

## Shtojca 14

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

\* \* \*

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_  
*numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

\* \* \*

[ Titullari i autoritetit kontraktor]

## Shtojca 15

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**



## Shtojca 16

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME** **Mallrat – Tender i Hapur**

#### **Neni 1: Qellimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifrat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikant e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkuara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

#### **Neni 6: Pronësia Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7: Origjina e Mallrave**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nënkontraktuesit që siguron mallrat.

### **Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmëria e Mallrave me Specifikimet**

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat në përputhje me cilësinë, sasinë dhe llojin e specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçëm të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.
- 8.3 Nëse shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si të modelit ose kampionit.

### **Neni 9: Përputhshmëria e Mallrave me Standardet Teknike**

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standard Teknik përkatës në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike ndërkombëtare. Nëse nuk ekzistojnë Standarde Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standardeve Teknike përkatëse Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban përgjegjësi për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shitësi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të Mallrave për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose përfaqësimin e reklamës së shitesit (Kontraktuesit).

### **Neni 10: Pjesët e Këmbimit**

